

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
KOMUNËN PREZË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Komunën Prezë, njësi administrative e Bashkisë Vorë**, me objekt: *“Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë”*, për periudhën e veprimtarisë 1.01.2013 deri më datë 31.05.2015 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 105, datë 27.08.2015.

Bazuar në nenet mbështetje të neneve 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 502/6, datë 30.05.2015, i ka rekomanduar z.Fiqiri Ismaili, Kryetar i Bashkisë Vorë, ku përfshihet si njësi administrative ish komuna Prezë, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.1. Gjetje nga auditimi: Në mjaft raste të kryerje së prokurimit të fondeve publike me procedurën e prokurimit me vlera të vogla dhe disa mangësi në drejtim të moszbatimit të urdhrit të Ministrisë së Financave nr. 33, datë 11.7.2013 “Për gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”, i hartuar në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, nenin 43 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 Për menaxhimin e sistemit buxhetor” dhe nenet 15 e 22 të ligjit 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin Financiar e kontrollin” e konkretisht:

- Mungonte kërkesa e argumentuar nga sektorët e interesuar për kryerjen e shpenzimit brenda limitit që përcakton ligji të blerjet me vlera të vogla;
- Nuk ishin përcaktuar sipas rastit specifikimet teknike të shërbimit, apo mallit që do të blihej;
- Nuk evidentohet ngritja e grupit për testimin e tregut dhe as çmimet e marra për bazë në llogaritjen e fondit limit.

1.2 Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Vorë (për llogari të NJQV Komuna Prezë) në çdo rast të prokurimit të fondeve publike me procedurën e prokurimit të blerjeve me vlerë të vogël, të bëhet kërkesë e argumentuar për domosdoshmërinë e kryerjes së shpenzimit, të hartohet sipas rasti preventivi dhe specifikimet teknike të mallit, punës, apo shërbimit dhe të pasqyrohet testi i tregut, apo të dhënave statistikore, për përcaktimin e çmimit dhe argumentimin e fondit limit .

Në vijimësi

2.1. Gjetje nga auditimi: Janë hapur dosje individuale për secilin subjekt, por mungon inventari për përmbajtjen e materialeve në dosje dhe numri i fletëve. Dosjet nuk janë azhurnuar dhe përditësuar dhe të plotësuar me dokumentacionin e nevojshëm, pasi në disa prej tyre mungon njoftim detyrimi, njoftim vlerësimi tatimor dhe dokumenti i pagesës së detyrimit, (mandat arkëtimi), ndërsa në disa dosje mungojnë; deklaratat parashikuese të qarkullimit vjetor, gen-planet, apo planimetritë kjo për taksën e ndërtesave, etj.

2.2 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Tatim Taksave të Bashkisë Vorë (për llogari të NJQV Komuna Prezë) të merren masa që për aktivitetin fiskal në vitin 2015, dosjet e subjekteve të plotësohen me: Deklaratat parashikuese të qarkullimit vjetor; Njoftim vlerësimi tatimor; Njoftim detyrimin; Dokumenti i Pagesës së detyrimit, (Mandat arkëtimi); Gent Planet apo planimetritë për taksën e ndërtesave, si dhe Aktkonstatimet apo aktverifikimet për mbylljen e aktivitetit, të konfirmuara dhe nga Policia.

Brenda muajit Nëntor 2015

3.1 Gjetje nga auditimi: Për vitet 2013 dhe 2014, për 8 subjekte të pa regjistruara, nuk ka gjetur zbatim të plotë ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 41- Identifikimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare pa u regjistruar, ku në pikën 1.

3.2 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Tatim Taksave të Bashkisë Vorë (për llogari të NJQV Komuna Prezë) të merren masa për regjistrimin e subjekteve dhe të ndiqen hapat e nevojshme ligjore për arkëtimin e detyrimeve tatimore dhe të kontributeve për sigurimet shoqërore e shëndetësore, për subjektet që kanë ushtruar aktivitet të pa regjistruar në QKR.

Brenda muajit Nëntor 2015

4.1. Gjetje nga auditimi: Nuk janë të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR), 8 subjekte, që kryejnë aktivitete të ndryshme biznesi, të cilët ushtrojnë aktivitetin pa u licencuar dhe nuk paguajnë taksë biznesi të vogël dhe tarifën vendore. Ndaj 37 subjekteve të paregjistruar në QKR, nga Zyra e Taksave të Bashkisë Divjakë, bazuar në nenet 11, 22 dhe 32 të ligjit nr. 9632, datë 31.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, është bërë vlerësimi, dhe kanë llogaritur në planifikim të ardhura për buxhetet e viteve 2013 dhe 2014 për këto biznese të palicensuar, **duke sjellë mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë për vlerën 359,460 lekë**.

4.2. Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Tatim Taksave të Bashkisë Vorë (për llogari të NJQV Komuna Prezë), bazuar në nenin 70, pika 3, “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, për 9 subjektet (sipas pasqyrës) të evidentuara si të palicensuara, të kryhen llogaritjet, për detyrimet e gjobat dhe të nxirren njoftimet e vlerësimit për detyrimet që kanë ndaj Komunës, për vlerën gjithsej **359,460 lekë**, dhe të kërkohet arkëtimi i kësaj vlere.

Brenda muajit Nëntor 2015

5.1. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2013 rezultojnë debitorë 590 familje për mos shlyerjen e taksës së tokës për vlerën 930 mijë lekë dhe për taksën e ndërtesës 646 familje në vlerën 492 mijë lekë. Për tarifën e pastrimit dhe të varrezave janë debitorë 446 familje, përkatësisht për vlerën 535 mijë lekë dhe 446 mijë lekë.

Për vitin 2014 rezultojnë debitorë 523 familje për mos shlyerjen e taksës së tokës për vlerën 1,450 mijë lekë. Për taksën e ndërtesës janë debitorë 581 familje në vlerën 845 mijë lekë. Për tarifën e pastrimit dhe të varrezave janë debitorë 381 familje, përkatësisht për vlerën 457 mijë lekë dhe vlerën 381 mijë lekë.

Gjithsej vlera debitore e subjekteve familjare arrin në shumën 4,114 mijë lekë, nga e cila 1,450 lekë për taksën e tokës, 845 mijë lekë për taksën e ndërtesës, 992 mijë lekë për tarifën e pastrimit dhe 827 mijë lekë për tarifën e varrezave.

5.2. Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Tatim Taksave të Bashkisë Vorë (për llogari të NJQV Komuna Prezë), të merren masa për arkëtimin e detyrimeve debitore të pa arkëtuara deri më datën 30.9.2014 për të 4 llojet e taksave të popullatës në vlerën 4,114 mijë lekë, përkatësisht: për taksën e tokës, në vlerën 1,450 mijë lekë, taksa e banesave në vlerën 845 mijë lekë, taksa e pastrimit në vlerën, 992 mijë lekë dhe tarifën e varrezave në vlerën 827 mijë lekë.

Brenda muajit Nëntor 2015

6.1. Gjetje nga auditimi: Deri në datën 30.12.2014 rezultoi se për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë (subjektet e biznesit të vogël, biznesit të madh), **në vlerën prej 9,666,926 lekë**.

Në vlerën e mësipërme për periudhën objekt auditimi, përfshihen debitorët e biznesit të vogël në vlerën **1,859,516 lekë për vitin 2013**, debitorët e taksave dhe tarifave vendore për subjektet që ushtrojnë aktivitetet **për vitin 2014 në vlerën 639,822 lekë**, dhe debitorët e biznesit të madh për detyrimet e taksave e tarifave vendore në vlerën **7,167,588 lekë**, kjo në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar, neni 114, “Mospagimi në afat i detyrimit tatimor apo kontributit”.

6.2. Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Tatim Taksave të Bashkisë Vorë (për llogari të NJQV Komuna Prezë) në bashkëpunim me Policinë Bashkiake dhe Drejtorinë e Financës, të merren masa në zbatim të procedurave ligjore, për arkëtimin e vlerës **9,666,926 lekë**, për subjektet debitorë të biznesit të vogël dhe të madh, (Sipas pasqyrave përkatëse).

Brenda muajit Nëntor 2015

7.1. Gjetje nga auditimi: Me VKM nr. 4, datë 07.01.2005 “Për transferimin në pronësi të komunës Prezë, Tiranë, të repartit ushtarak nr.3800/1, Batalioni “AKA” në Prezë, Tiranë të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003 të KM “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi MB”, të ndryshuar”, por nga auditimi në terren u konstatua se territori i tij ishte i zaptuar dhe pjesërisht i zënë me ndërtime pa leje.

7.2. Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Vorë (për llogari të NJQV Komuna Prezë) në bashkëpunim me Policinë Bashkiake dhe Policinë e Rendit, të merren masa për lirim të territoreve dhe objekteve të ish-repartit ushtarak. Po ashtu ti kërkohet konfirmim ALUIZNI nëse objektet e ndërtuara janë apo jo objekti trajtimi ligjor nga ky institucion dhe në varësi të korrespondencës të merren masa për eliminimin e ndërtimeve të paligjshme.

Brenda muajit nëntor 2015

8.1. Gjetje nga auditimi: Për të gjitha asetet e kaluara me VKM në pronësi të Komunës Prezë, është vepruar në kundërshti me Kapitullin III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 26 dhe 27 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nëpunësi autorizues nuk ka caktuar nëpunësin zbatues për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit kontabël të gjithë aktiveve që zotëron apo ka në administrim.

Po ashtu në kundërshtim me nenin 31/d, nuk është mbajtur regjistri i veçantë për secilën nga pasuritë e dhëna me qira ku të përcaktohet sipërfaqja e objektit në metra katrorë, numri dhe data e kontratës së qirasë, afati i vlefshmërisë së kontratës, afati i qirasë, veprimtaria që kryhet, subjekti përfitues, qiraja mujore dhe arkëtimet sipas muajve të vitit kalendarik.

8.2. Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Vorë (për llogari të NJQV Komuna Prezë) të merren masat dhe të kryhen të gjitha procedurat për mbajtjen e regjistrit kontabël të të gjithë aktiveve që zotëron apo ka në administrim, si dhe regjistri i veçantë për secilën nga pasuritë e dhëna me qira ku të përcaktohet sipërfaqja e objektit, kontrata e qirasë, afati i vlefshmërisë, veprimtaria që kryhet, subjekti përfitues, qiraja mujore, arkëtimet sipas muajve të vitit kalendarik, etj.

Në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar, kreu IV, nenet 9-14, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, kreu I, nenet 105-109, ana e Bashkisë Vorë (për llogari të NJQV Komuna Prezë) të nxirren aktet administrative, të kryhen kontabilizimet dhe të kërkohet **shpërblymimi i dëmit në vlerën 4,735,927 lekë**, si më poshtë:

1.1. Gjetje nga auditimi: Në zbatim të rregullshmërisë së dokumentacionit të pagesave u konstatua përdorimi i faturave tatimore me TVSH nga persona fizikë, të cilët, që nuk janë të përfshirë në skemën e TVSH-së dhe kanë përfituar tepër vlerën e TVSH-së në 1 rast në shumën 21,800 lekë, si më poshtë:

- Me urdhër shpenzimit nr. 84, datë 23.4.2014 me shumën 130,800 lekë është paguar personi fizik E.B për servis kompjuteri. Dokumenti është hartuar mbi bazën e faturës tatimore nr. 20, datë 11.4.2013, e cila është përpiluar me TVSH në masën 20% në shumën 21,800 lekë, të cilën duhet ta kthejë.

1.2. Rekomandimi: Të merren të gjitha masat duke kryer të gjitha veprimet administrativo-procedurale për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e shumës prej **21,800 lekë**, përfituar padrejtësisht nga personi fizik E.B, si pasojë e pagesës së shërbimeve për mirëmbajtje pajisje kompjuterike, kur subjekti nuk i nënshtrohet tvsh-së.

Menjëherë

2.1. Gjetje nga auditimi: Me urdhër të Kryetarit nr 2. datë 04.02.2013 janë dhënë orë jashtë orarit të punës për 6 persona për periudhën dhjetor 2012 dhe janar 2013, në **vlerën prej 214,127 lekë, shumë e cila përbën dëm ekonomik** pasi përfitimi i këtyre pagesave është në kundërshtim me pikën nr. 2 të UMF nr. 1, datë 20.07.2011 “Mbi Zbatimin e vendimit nr. 463 datë 16.06.2011 të Këshillit të Ministrave”.

2.2. Rekomandimi: Të merren të gjitha masat duke kryer të gjitha veprimet administrativo-procedurale për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e shumës prej **214,127 lekë**, përfituar padrejtësisht nga 6 punonjës, si pasojë e pagesës të orëve jashtë orarit zyrtar të punës.

Menjëherë

3.1. Gjetje nga auditimi: Nga IMKT, janë marrë 15 vendime për pezullimin e ndërtimeve pa leje, por nuk janë zbatuar kërkesat e ligjit lidhur me vendosjen e gjobave, kjo në kundërshtim me pikën 8 “Kryerja punimesh pa leje” të ligjit nr. 10119 datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit” ku në gjurmën a) thuhet: Kryerja e punimeve pa leje pa pasoje në krijimin e shtesave në sipërfaqe e vëllim ndërtimor dënohet me gjobë nga 300 000 deri në 30% të vlerës totale të punimeve të ndërtimit. Pra për 15 objektet e konstatuara si ndërtim pa leje për vitet 2013 e 2014 INUV Komuna Prezë duhej të kishte gjobitur subjektet me vlerën minimale 300,000 x15 subjekte= **4,500,000 lekë, të ardhura të munguar me dëm ekonomik për buxhetin e njësisë vendore.**

3.2. Rekomandimi: Të merren të gjitha masat duke kryer të gjitha veprimet administrativo-procedurale duke vendosur fillimisht gjobën minimale prej 300,000 lekë për secilin subjekt shkelës të ligjit nga ngritja e ndërtimeve pa leje dhe kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e shumës prej **4,500,000 lekë.**

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenet 58, germa a, b, c, ç, “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, si dhe nenit 8, të kontratave individuale të punës, në nenin 44, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i kemi rekomanduar Kryetarit të Njësisë së Qeverisjes vendore, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës të cituar më poshtë dhe marrjen e masave disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Largim nga puna” dhe për ata me kontratë, nga masa “Vërejtje” deri në “Ndërprerje të marrëdhënieve të punës”, për këta punonjës:

1. z. A.B, me detyrë Kryeinspektor për periudhën 2014 dhe në vazhdim.

Nga IMKT, janë mbajtur 12 procesverbale konstatimi, për të cilat sipas dokumentacioni në secilën dosje, nuk ishte parashikuar ndonjë afat apo vendim për zbatimin e të metave të mësipërme për shkeljet e konstatuara, veprime në kundërshtim me nenin 13 “Dhënia e vendimeve administrative dhe afateve” të ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007.

Nga IMKT, janë marrë 15 vendime për pezullimin e ndërtimeve pa leje, por nuk janë zbatuar kërkesat e ligjit lidhur me vendosjen e gjobave, në vlerën **4,500,000 lekë, të ardhura të munguar me dëm ekonomik për buxhetin e njësisë vendore, Komuna Prezë**, veprime gjithashtu në kundërshtim me kërkesat e nenit 5 germa b të ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për inspektoratin e ndërtimit”, nenit 82 të ligjit nr. 10119 datë 23.04.2009, si dhe pikës 4 të nenit 30 “Arkëtimi i shumave të detyrimeve” të kërkesave të ligjit nr. 10279 datë 20.05.2010.

2. z. O.K, me detyrë Kryeinspektor i INUV për periudhën janar 2013-mars 2014 dhe detyrë përgjegjës i Zyrës së Financës, për periudhën nga Prill 2004 e vazhdim

Nga IMKT, janë mbajtur 12 procesverbale konstatimi, për të cilat sipas dokumentacioni në secilën dosje, nuk ishte parashikuar ndonjë afat apo vendim për zbatimin e të metave të mësipërme për shkeljet e konstatuara, veprime në kundërshtim me nenin 13 “Dhënia e vendimeve administrative dhe afateve” të ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007.

Nga IMKT, janë marrë 15 vendime për pezullimin e ndërtimeve pa leje, por nuk janë zbatuar kërkesat e ligjit lidhur me vendosjen e gjobave, në vlerën **4,500,000 lekë, të ardhura të munguar me dëm ekonomik për buxhetin e njësisë vendore, Komuna Prezë**, veprime gjithashtu në kundërshtim me kërkesat e nenit 5 germa b të ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për inspektoratin e ndërtimit”, nenit 82 të ligjit nr. 10119 datë 23.04.2009, si dhe pikës 4 të nenit 30 “Arkëtimi i shumave të detyrimeve” të kërkesave të ligjit nr. 10279 datë 20.05.2010.

Për shkelje e mangësi në zbatimin e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2011 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, pasi:

Për pagesën sipas urdhrit të Kryetarit nr 2. datë 04.02.2013 orë jashtë orarit të punës për 6 persona për periudhën dhjetor 2012 dhe janar 2013, në **vlerën prej 214,127 lekë, shumë e cila përbën dëm ekonomik** pasi përfitimi i këtyre pagesave është në kundërshtim me pikën nr. 2 të UMF nr. 16, datë 20.07.2011 “Mbi Zbatimin e vendimit nr. 463 datë 16.06.2011 të Këshillit të Ministrave”.

Për mangësi në drejtim të moszbatimit të urdhrit të Ministrisë së Financave nr. 33, datë 11.7.2013 “Për gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”,

Për nxjerrjen jashtë përdorimit të automjetit me targë TR 7072 J, në kundërshtim me paragrafin nr. 109 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

3. znj. H.D, me detyrë ish-Përgjegjëse e Zyrës së Financës deri në muajin prill të vitit 2014

Për shkelje e mangësi në zbatimin e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2011 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, pasi:

Për pagesën sipas urdhërit të Kryetarit nr 2. datë 04.02.2013 orë jashtë orarit të punës për 6 persona për periudhën dhjetor 2012 dhe janar 2013, në **vlerën prej 214,127 lekë, shumë e cila përbën dëm ekonomik** pasi përfitimi i këtyre pagesave është në kundërshtim me pikën nr. 2 të UMF nr. 16, datë 20.07.2011 “Mbi Zbatimin e vendimit nr. 463 datë 16.06.2011 të Këshillit të Ministrave”.

Për mangësi në drejtim të moszbatimit të urdhrit të Ministrisë së Financave nr. 33, datë 11.7.2013 “Për gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”,

Për nxjerrjen jashtë përdorimit të automjetit me targë TR 7072 J, në kundërshtim me paragrafin nr. 109 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

4. z. L.V, me detyrë, përgjegjës i Zyrës së Tatim Taksave, si dhe me detyrë anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave

Për vjeljen e detyrimeve tatimore nga ana e Zyrës së Taksave e Tarifave Vendore në Komunën Prezë, nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme ligjore të mëposhtme:

-Nuk i është dërguar lista e subjekteve debitore zyrtarisht Zyrës së Financës.

-Nuk i është kërkuar Këshillit të Bashkisë, ndërhyrje me forcë e Policisë së Komunës dhe strukturave të tjera, për vjeljen e detyrimeve të subjekteve debitore, siç parashikohet në nenin 5, shkronja “ç” nënpika “iii”, të ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”

-Subjektet që nuk i kanë paguar detyrimet tatimore në afat, ndaj tyre nuk ishte bërë llogaritja e kamat vonesave në masën 5 për qind në muaj, por jo më tepër se në masën 25 për qind, bazuar në nenin 114 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”. Llogaritjet u bënë gjatë auditivit, por për to nuk kanë dijeni subjektet private tatimpaguese.

-Nuk është kërkuar që ndaj subjekteve debitore vendosja e barrës siguroese (Drejtorinë Rajonale të Transportit (për mjetet), apo Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, kjo bazuar në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat tatimore”, dhe konkretisht në nenin 91.

Për shkelje e parregullsi në zbatimin e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), në procedurat e prokurimit, me objekt:

“Rikonstruktion dhe asfaltim i rrugëve lidhëse Gjec-Kodër-Ahmetaq”.

“Blerje karburanti 2013”, “Pyllëzim me arror të llojit shegë”, “Ndërtim mbrojtje lumore Fshati Fushë-Prezë si dhe veshje e KUL-se Fshati Gjec Kodër” dhe “Blerje karburanti 2014”.

5. z. L.Ll, me detyrë Përgjegjës i Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit, si dhe me detyrë anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave

6. z. M.D, me detyrë Specialist i Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit, si dhe me detyrë anëtar i Njesisë së Prokurimit

7. z. Sh.H, me detyrë Specialist i Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit, si dhe me detyrë anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave

Në asnjë rast nuk ka certifikatë apo vërtetim pronësor të lëshuar nga ZVRPP, lidhur me regjistrimin e infrastrukturës të nevojshme për funksionimin e zhvillimin e investimit i cili e lidh zhvillimin e ri me rrjetet ekzistuese të infrastrukturave dhe që realizohet nga zhvilluesi.

Miratimin e lejeve të përdorimit për objektet e mësipërme në mungesë të certifikatës së provave të materialeve të përdorura lëshuar nga laboratorët e përcaktuar, përfundimet e provave të ngarkesës, si dhe dokumentet që vërtetojnë se objekti është zbatuar në përputhje me projektzbatimin, pa shmangie në drejtimet funksionale dhe statike, këto në kundërshtim me nenin 11 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” të ndryshuar.

Në asnjë rast nuk rezulton në dosjen e praktikës së lejes së Ndërtimit dhe Përdorimit, vërtetim nga Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Vendor lidhur me pagesën e detyrimeve për gjoba apo

tarifa shërbimi, si dhe nuk është mbajtur korrespondencë zyrtare ndërmjet DPKZH dhe INUV.

Për veprime në kundërshtim me ligjin Ligji nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, i ndryshuar me ligjin nr. 10258, datë 25.03.2010 dhe ligjin nr. 107/2014, Aktin normativ nr. 4, datë 25.8.2010 (miratuar me ligjin nr. 10315, datë 16.9.2010), ligjin nr. 10360, datë 16.12.2010, ligjin nr. 22/2013 dhe ligji nr. 110/2013, datë 01.04.2013, VKM nr. 502, datë 13.07.2011 “Për miratimin e rregullores të kontrollit të zhvillimit të territorit” e ndryshuar me VKM nr. 88, datë 07.02.2012, VKM nr. 139, datë 22.02.2012, VKM nr. 345, datë 09.05.2012 dhe VKM nr. 314, datë 13.3.2013, ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit” dhe ligjin nr. 8420, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”.

Për shkelje e parregullsi në zbatimin e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), në procedurat e prokurimit, me objekt:

“Rikonstruktion dhe asfaltim i rrugëve lidhëse Gjec-Kodër-Ahmetaq”, “Blerje karburanti 2013”, “Pyllëzim me arror të llojit shegë”, “Ndërtim mbrojtje lumore Fshati Fushë-Prezë si dhe veshje e KUL-se Fshati Gjec Kodër” dhe “Blerje karburanti 2014”.

8. z. B.C, 9. z. I.K, 10. z. A.P, 11. z. A.V, me detyrë jurist dhe anëtar i Njësisë së Prokurimit

12. z. A.K, me detyrë Kryetar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave

13. z. K.B, me detyrë anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave

Për shkelje e parregullsi në zbatimin e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), në procedurat e prokurimit, në 5 tendera.

Nga Bashkia Vorë, ku përfshihet njësia administrative Prezë, ka kthyer përgjigje sëbashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë pranuar plotësisht.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit shtetëror Ryisin Xhaja, Vasillaq Peçi dhe Selman Hysa, më tej u shqyrtua nga z. Niko Nako kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT